VENDIM
Nr. 61, datë 12.4.2024

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË "PROTERGIA ENERGY ALBANIA" SHPK, NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa "d", 5, pika 1, germa "d" dhe 13 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.4.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 690/5 prot., datë 9.4.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, "Mbi licencimin e shoqërisë 'Protergia Energy Albania' sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Shoqëria "Protergia Energy Albania" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE nr. 690 prot., datë 22.2.2024, paraqiti aplikimin për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike dhe Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 33, datë 27.3.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e kësaj shoqërie në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 28.3.2024 dhe 29.3.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 8.4.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se aplikuesi ka plotësuar tërësisht dokumentacionin në zbatim të përcaktimeve të nenit 9 të rregullores: për pikën 1.1, germat "a", "b" dhe "c"; për pikën 1.2, germat "a", "b", "c" dhe "d", për pikën 1.3, germat "a", "b" dhe "c"; për pikën 2.4, germat "a", "b", "c" dhe "d".

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë "Protergia Energy Albania" sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË

Erjola Sadushi